



Informacione më të detajuara në lidhje me masën

7.3 MBËSHTETJA E SIPËMARRËSISË DHE THEMELIMI I SUBJEKTEVE JURIDIKË - OFRUES TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT NË KOMUNITET

Qëllimi i masës:

Mbështetje për krijimin e vendeve të reja të punës përmes hapjes së subjekteve të rinj juridikë - shoqatave të qytetarëve (ofrues të ardhshëm të shërbimeve sociale) që do të ofrojnë shërbime të kujdesit në komunitet.

Informacione të përgjithshme:

Kjo masë parashikon mbështetje për themelimin e subjekteve juridikë përmes formimit të Shoqatave të qytetarëve që do të angazhohen me aktivitete ekonomike në fushën e shërbimeve sociale për t'u zhvilluar në ofrues të shërbimeve të kujdesit në komunitet për personat me aftësi të kufizuara, personat me sëmundje kronike më të rënda dhe personat me sëmundje afatgjata. Shërbimet që do të ofrohen nga subjektet e sapoformuara juridike do të harmonizohen me Ligjin për mbrojtje sociale, dhe procedurat që janë përcaktuar ose do të përcaktohen nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Përmes kësaj mase do të ofrohen shërbime për ndihmë dhe kujdes në shtëpi dhe shërbime në komunitet që kanë të bëjnë, por që nuk përkufizohen në:

- Shërbime për zëvendësimin e kujdesit familjar përmes të cilit ofrohet një kujdes afatshkurtër i anëtarëve të varur të familjes për shkak të zëvendësimit, pushimit dhe plotësimit të nevojave personale dhe profesionale të anëtarëve të familjes që kujdesen për ta.
- Shërbime sociale-shëndetësore me të cilat ofrohet kujdesi afatgjatë për personat e sëmurë që përfshijnë shërbime të ndryshme shëndetësore, shërbime të ndërlidhura shëndetësore dhe sociale me të cilat u ndihmohet personave me kufizime funksionale për shkak të gjendjeve fizike, kognitive ose gjendje mendore ose përkufizime. Këto shërbime përfshijnë ndihmë gjatë aktiviteteve të jetës së përditshme (siç janë: ushqimi, larja dhe veshja) dhe gjatë aktiviteteve instrumentale të jetës së përditshme (siç janë: gatimi, pagesa e faturave, etj.), në një periudhë më të gjatë kohore, shërbimi i kujdesit mjekësor - procedurat dhe shërbimet mjekësore që kërkojnë praninë e stafit të specializuar dhe shërbimeve të specializuara siç janë: fizioterapia, terapia profesionale.

Kjo masë do të sigurojë mbështetje për subjektet juridikë të sapokrijuar, si dhe për personat që do të realizojnë punësimin e tyre në subjektet juridikë të sapokrijuar. Mbështetja përmes masave përfshin:

- Mbështetje këshilluese profesionale gjatë formimit të një subjekti të ri juridik – Shoqata të qytetarëve që do të angazhohen me aktivitete ekonomike në fushën e shërbimeve sociale për t'u zhvilluar në ofrues të shërbimeve të kujdesit të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me sëmundje kronike.
- Trajnim për sipërmarrësinë dhe planifikimin afarist për personat e papunë të cilët janë të interesuar për formimin e subjektit juridik për të ofruar shërbime në komunitet dhe shërbime të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi.
- Trajnim për ofrimin e shërbimeve sociale në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale dhe aktet e tjera nënligjore për personat e papunë që shprehin interes për formimin e subjektit juridik për ofrimin e shërbimeve në komunitet dhe shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi.
- Mbështetje këshilluese profesionale për hartëzimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit në bashkësinë lokale. Ky shërbim këshillues do të ketë për qëllim fuqizimin e aftësive të punëdhënësve (sipërmarrësve) për të identifikuar përfituesit e mundshëm dhe për të kuptuar nevojat e komunitetit lokal, me ç'rast fokusi kryesor do të jetë në krijimin e marrëdhënieve të partneritetit me të punësuarit në vetëqeverisjen lokale (komunën) dhe institucionet dhe organizatat e tjera lokale në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore dhe krijimin e rrjetit për mbështetjen e përdoruesve fundorë.
- Mbështetje për përgatitjen deri më 15 biznes-planeve nga biznes-idetë e përzgjedhura me sukses.
- Sigurimi i grant (fonde të pakthyshme) për 10 biznes-plane të përzgjedhura me sukses që do të regjistrojnë subjekt juridik - Shoqatë e qytetarëve që do të veprojnë në fushën e mbrojtjes sociale, ofrimin e shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi dhe në komunitet. Shuma e grantit është planifikuar të jetë 307,500 denarë.
- Mbështetja përmes ofrimit të trajnimit profesional për personat e papunë të cilët, pas marrjes së një certifikate për trajnimin e përfunduar me sukses, do të punësohen në personin juridik si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve të ndihmës dhe kujdesit në komunitet konform nevojave të subjektit juridik, gjegjësisht, përdoruesve fundorë. Për nevojat e subjekteve juridikë (ofruesve të shërbimeve) është planifikuar të trajnohen 60 persona të papunë dhe të zhvillohet një rrjet i asistentëve të aftë dhe të kualifikuar për ndihmë dhe kujdesje, edukatorë dhe persona profesional.
- Subvencionim i punësimit të personit që do të ketë rolin e menaxherit në subjektin juridik dhe subvencionimi i punësimeve shtesë në subjektet juridikë maksimum deri në 50 persona të papunë në suazat e kësaj mase, në bazë të bruto pagës mujore në një shumë prej 29.180 denarë për një periudhë prej 10 muajsh.
- Në një subjekt juridik, mund të subvencionohen maksimum deri 6 persona, përmes subvencionimit të siguruar të pagës për vetëpunësimin e realizuar për pozicionin e menaxherit / drejtuesit të subjektit juridik / Shoqatë e qytetarëve në pjesën e aktiviteteve ekonomike të mbështetur nga kjo masë dhe deri në 5 punësime të subvencionuara për personat me dokument (certifikatë) përkatëse për ofrues të shërbimeve në komunitet dhe shërbimeve për ndihmë dhe kujdesje në shtëpi. Nëse nevojitet një numër më i madh i ofruesve të shërbimeve në komunitet konform nevojave të hartëzuara në nivel lokal, për të

njëjtën vendos Grupi i punës.

- Shumë e njefishtë deri 3.500 denarë për konsumator për subjektet juridike / shoqatat e qytetarëve për të mbuluar kostot operative dhe kostot e menaxhimit.
- Mbështetje mentoruese / këshilluese për ofruesit e punësuar të shërbimeve. Këtë shërbim (individual ose grupor) do ta ofrojnë personat e angazhuar profesionistë - ekspertë në fushën e shërbimeve sociale.
- Mbështetje mentoruese / këshilluese për subjektin juridik / shoqatë e qytetarëve, gjegjësisht, personin e ri të punësuar përgjegjës për menaxhimin dhe zhvillimin e veprimtarisë afariste të subjektit - ofrues i shërbimeve dhe mbështetje të procesit për arritjen e kontratës menaxheriale me institucionin kompetent.

#MundësiPërTëGjithë

Për më shumë informacione, kontaktoni personat –
Zerina Ramiqeviq (zerina.ramikevik@undp.org);
Viktorija Neshkovska Karakoteva (viktorija.neshkovska@undp.org)



Република Северна Македонија
Министерство за труд
и социјална политика



АГЕНЦИЈА ЗА ВРАБОТУВАЊЕ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

